



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Ftesë për Ofertë

SHQIPËRI PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Titulli dhe Numri i Ftesës për Ofertë:

Rehabilitimi i skemës së Ujitjes Murriz – Thanë, Krutje (V1 & V2) (ICB No: MAFCP/W/ICB/005) (sipas Planit të Prokurimit)

Nr. i Projektit: P121186
Huaja IBRD: No.: 8211 - AL

1. Kjo Ftesë për Ofertë është në vazhdim të Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë Projekt të publikuar në *Development Business* online më 25 Maj 2010 dhe Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit të përditësuar, publikuar më 20 Dhjetor 2012, me Nr. Reference DB No.WB5260-12/12.
2. Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore kundrejt kostos së Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes dhe synon të aplikojë pjesë nga ky financim kundrejt pagesës për Kontratën e Punimeve Civile për “**Rehabilitimin e skemës së ujitjes Murriz – Thanë, Krutje (V1 & V2)**” (ICB No: MAFCP/W/ICB/005). Tenderimi do të behet në përputhje me rregullat dhe procedurat e e Bankës Botërore.
3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) fton oferta të mbyllura nga ofertues të pranueshëm dhe të kualifikuar për Kontratën e Punimeve Civile për “**Rehabilitimin e skemës së ujitjes Murriz – Thanë, Krutje (V1 & V2)**” (ICB No: MAFCP/W/ICB/005), që përbëhet nga ekstremitetet V1 & V2 të degës Kryesore të Krutjes (Murriz – Thanë), e cila mbulon një zonë të caktuar rreth 4,300 ha.

Një përshkrim i shkurtër i punimeve, që do të kryhen nën këtë kontratë është përmbledhur më poshtë:

- Pastrimi, riseksionimi dhe shtrimi me beton i gjithë gjatësisë së kanalit kryesor dhe kanaleve sekondare për të dyja nën-skemat;

- Instalimi i strukturave të reja si duckbille (rregulluesit e niveleve), daljet, fugat, sifonet, kanalet etj.;
- Restaurimi i Stacionit të Pompave Bitaj (Pjesë e V1);

Skema e Ujitjes Krutje V1 ndodhet në Libofshë, Bashkia Fier dhe mbulon një zonë të caktuar rreth 1,300 ha. Ajo përfshin degët kryesore dhe kanalet sekondare si dhe Stacionin e Pompave Bitaj. Degët kryesore të V1 kanë një gjatësi rreth 7.6 km dhe gjatësia totale e kanaleve sekondare është 11.2 km.

Skema e Ujitjes Krutje V2 ndodhet në Divjakë, Bashkia Divjakë dhe mbulon një zonë të caktuar rreth 3,000 ha. Ajo përfshin degën kryesore dhe kanalet sekondare si dhe rrjetin terciar. Dega kryesore e V2 ka një gjatësi 13.3 km dhe gjatësia totale e kanaleve sekondare është 10.23 km.

Periodha e ndërtimit është **8 (tetë) muaj** pas firmosjes së kontratës, përfshirë **2 (dy) javë** mobilizim të kontraktorit. Periodha e Përgjegjësisë për defektet do të jetë **12 muaj** pas përfundimit të zbatimit të Punimeve Civile, si domosdoshmëri;

4. Tenderi do të zhvillohet sipas procedurave të Tenderit të Hapur Ndërkombëtar siç përcaktohen në Udhëzimet e Bankës Botërore: Prokurimi i Mallrave, Punimeve të Ndërtimit dhe Shërbimeve Jo konsulencë nën huatë IBRD dhe kreditë IDA dhe Grantet, botimi Janar 2011 (“Udhëzimet e Prokurimit”) dhe është i hapur për të gjithë konkurrentët nga vende të pranueshëm, siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimit. Përveç kësaj, ju lutemi, referojuni paragrafeve 1.6 dhe 1.7, ku përcaktohen politikat e Bankës mbi konfliktin e interesit.
5. Konkurrentët e pranueshëm të interesuar mund të marrin informacion të mëtejshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR): Z. Ilirjan Lame, Menaxher Projekti, e-mail: ilirjan.lame@bujqesia.gov.al dhe të shikojnë dokumentat e tenderit gjatë orarit zyrtar 08.00 am deri 16.30 (nga e Hëna deri të Enjten) dhe 8.00 am deri 14.00 të Premten (ora Lokale) në adresën e dhënë më poshtë: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Blv. Dëshmorët e Kombit, Nr.2; Tiranë, Shqipëri. Dokumentat e tenderit mund të shikohen gjithashtu dhe në adresën www.bujqesia.gov.al
6. Kërkesat për kualifikim përfshijnë një numër minimum të kontratave të ngjashme në **ndërtimin/rehabilitimin e sistemeve të Ujitjes**: Më pak se ose baraz me 3 kontrata, secila me një vlerë minimum 950,000 Euro (Nëntëqind e Pesëdhjetë Mijë Euro), por, me një vlerë totale të të gjithë kontratave baraz ose më shumë se 2,850,000 Euro (Dy Milion e Tetëqind e Pesëdhjetë Mijë Euro). Ofertuesi duhet të demonstrojë se ka akses, ose ka në dispozicion likuiditete (liquid assets), pasuri të patundshme pa barra, linja krediti dhe mjete të tjera financiare (të pavarura nga çdo pagesë paradhënie kontraktuale), të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat për fluksin e mjeteve monetare të ndërtimit, të llogaritura në shumën **1.81 milion Euro** neto nga angazhimet e tjera të ofertuesve. Minimumi i Xhiros Mesatare Vjetore të Ndërtimit **9.05 milion Euro** brenda **5 (pesë) viteve** të fundit.
7. Një set i plotë i Dokumentave të Tenderit në gjuhën Anglisht mund të blihet nga ofertuesit e pranueshëm të interesuar kundrejt paraqitjes së një kërkesë me shkrim në adresën më poshtë dhe kundrejt pagesës së pakthyeshme prej **5.000 Lekë (Pesëmijë Lekë)**. Metoda e pagesës do të jetë transfertë bankare në numrin e llogarisë në Bankën “Credins”, Shqipëri.

Mbajtësi i Llogarisë:

**PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES, MBUMK
BLV DESHMORËT E KOMBIT NR. 2. 01101 TIRANE**

BANKA CREDINS

SWIFT: **CDISALTRXXX**
Numri i Llogarisë: **00000558388**
IBAN: **AL14212110160000000000558388**

8. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën më poshtë në ose para orës **12:00**, datë **06 Shkurt 2018**. Ofertimi elektronik nuk do të lejohet. Ofertat e vonuara do të refuzohen (nuk do të pranohen). Ofertat do të hapen publikisht në prezencë të përfaqësuesve të ofertuesve dhe atyre që zgjedhin të ndjekin hapjen në adresën më poshtë në orën **12:30** datë **06 Shkurt 2018**.
9. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen me një **“Deklaratë e Sigurimit të Ofertës”**, duke përdorur për këtë qëllim formatin e përfshirë në Seksionin IV të Dokumentave të Tenderit “Formatet e Tenderit”.
10. Adresat e referuara më lart janë:

Adresa për dorëzimin:

(Zyra e Protokollit) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr.2
Tiranë, Shqipëri.
Në vëmendje të: **Znj. Aurora ALIMADHI**
Kryetar i Autoritetit Kontraktor

Hapja Publike:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 2
Tiranë, Shqipëri (Kati 3^{te}, salla e mbledhjeve)

Website: www.bujqesia.gov.al